



## Procesi i integritit në Bashkimin Evropian

Republika e Kosovës aktualisht ka statusin e vendit kandidat potencial për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE).

Procesi i Stabilizim-Asociimit të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor është lansuar me 1 nëntor 2000, si kornizë e politikave evropiane për marrëdhëniet midis BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, deri në anëtarësimin eventual të tyre.

Me 27 tetor 2015 në Strasburg të Francës është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, e cila hyri në fuqi me 1 prill 2016.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) është marrëveshja e parë kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Kjo marrëveshje përcakton mekanizmat dhe afatet zyrtare për zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën në mënyrë progresive me BE-në, në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së.

Kuvendi i Kosovës në kuadër të zbatimit të MSA-së, më 10 mars 2017 ka miratuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së (PKZMSA), i cili përbën dokumentin kryesor kombëtar të politikave të anëtarësimin në BE. PKZMSA paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të reformave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA, respektivisht masat dhe prioritetet për përafrimin gradual të legjislacionit vendor me acquis të BE-së, nëpërmjet transpozimit të kësaj të fundit në të, si dhe për zbatimin e legjislacionit të përafuar.

Gjithashtu, institucionet e Kosovës kanë miratuar Agjendën për Reforma Evropiane, me qëllim përcaktimin e prioriteve për përmbushjen e obligimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

### Roli i parlamentit në procesin e anëtarësimin në Bashkimin Evropian

Deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët dhe janë përgjegjës para tyre. Kuvendi miraton ligje të cilat më pas zbatohen në mbarë vendin. Një pjesë e procesit të anëtarësimin në BE përfshin harmonizimin dhe përafrimin e ligjeve kombëtare me standardet e BE-së. Kjo shpesh duket e komplikuar dhe një gjë e largët nga jeta e përditshme e qytetarëve, veçmas nëse është një proces afatgjatë. Prandaj, Kuvendi i Kosovës dhe anëtarët e saj kanë një rol të veçantë për t'i sjellë më afër këto çështje, ide dhe vlera.

Kuvendi i Kosovës është pjesëmarrës kyç në procesin e anëtarësimin. Ai pasqyron opinionin kombëtar dhe e përfaqëson diversitetin qytetarë. Kuvendi i Kosovës mbikëqyr gjithë procesin dhe përfaqëson interesat kombëtar të Kosovës.

Detyrat e Kuvendit të Kosovës në kuadër të anëtarësimit në BE mund të grupohen në katër fusha aktivitetesh si në vijim:

### **Përafrimi dhe harmonizimi me legjislacionin e BE-së**

Me anë të miratimit të ligjeve, Kuvendi siguron transpozimin e *acquis* të BE-së në sistemin juridik të Kosovës.

Po ashtu, Kuvendi bën mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të miratuar, PKZMSA-së si dhe Agjendës për Reforma Evropiane.

### **Monitorimi dhe shqyrtimi i hollësishëm**

Kuvendi e autorizon qeverinë për përfaqësimin e pozicioneve të vendit në procesin e anëtarësimit dhe bën mbikëqyrjen nga afër të aktiviteteve të qeverisë përgjatë tërë procesit. Ndonëse qeveria është aktori kryesor në procesin e zgjerimit, shqyrtimi i hollësishëm parlamentar siguron konsensusin e mundshëm më të gjerë politik.

### **Aktivitetet për ndarjen e informacionit**

Kuvendi është burim i informacionit për publikun e përgjithshëm sa i përket integritimit në BE.

Përmes aktiviteteve të tij, ai është përgjegjës për forcimin e vlerave të transparencës dhe të shkëmbimit të informacionit.

### **Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-parlamentar**

Diplomacia parlamentare është një vlerë në procesin e zgjerimit, për forcimin e reputacionit ndërkombëtar dhe të mbështetjes për Kosovën. Kontaktet e rregullta me Parlamentin Evropian dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së, si dhe bashkëpunimi Parlamentar rajonal, janë kyç i suksesit të procesit të integritimit.

### **Komisionit për Integritime Evropiane në Kuvendin e Kosovës**

Komisioni për Integritime Evropiane (KIE) është një nga katër komisionet kryesore dhe aktori kryesor në Kuvendin e Kosovës në çështjet e integritimit në BE.

Përfshirja e KIE-së është e detyrueshme në procesin legjislativ. Ai merret me shqyrtimin e të gjitha projektligjeve dhe të amendamenteve të dorëzuara në Kuvend nga aspekti i përafrimit dhe harmonizimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, barra e punës legjislative është rritur në masë të konsiderueshme. Së këndejmi, aktualisht aktiviteti kryesor i komisionit ndërlidhet me përafrimin me legjislacionin e BE-së.

Në kuadër të monitorimit të ekzekutivit, KIE-së i është besuar mbikëqyrja e aktiviteteve të qeverisë në lidhje me BE-në, përfshirë këtu përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit. Për këtë qëllim, mund të kërkojë informata dhe të dhëna specifike, si dhe të iniciojë mbajtjen e dëgjimeve publike me ministrat dhe me zyrtarët tjerë.

Në përputhje me Rregulloren e Punës, fushëveprimi i detyrave dhe i përgjegjësive të KIE-së përfshin gjithashtu bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet e BE-së dhe me zyrat e tyre

në Kosovë, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira me vendet anëtare të BE-së, pjesëmarrjen si dhe mbikëqyrjen e Procesit të Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrjen dhe koordinimin e Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA), monitorimin e donatorëve dhe të programeve të bashkëpunimit të BE-së, bashkëpunimin me Këshillin e Evropës.

Në përgjithësi, KIE i mban dy deri në katër takime në muaj dhe zakonisht janë disa pika në rendin e ditës. Takimet e KIE-së janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë pjesëmarrës të rregullt.

## **Kalendari kohor: Marrëdhëniet e Kosovës me BE-në**

### **1 nëntor 2000**

*Nisja e Procesit të Stabilizim-Asociimit për Evropën Juglindore*

### **21 qershor 2003**

*Deklarata e Samitit BE-Ballkani Perëndimor*

### **1 prill 2005**

*Komunikata e Komisionit Evropian e ardhmja evropiane për Kosovën*

### **4 shkurt 2008**

*Veprimi i përbashkët për themelimin e EULEX-it në Kosovë*

### **17 shkurt 2008**

*Shpallja e pavarësisë së Kosovës*

### **9 dhjetor 2008**

*EULEX-i bëhet operacional*

### **14 tetor 2009**

*Komunikata e Komisionit Evropian Kosova-Realizimi i perspektivës evropiane të saj*

### **19 janar 2012**

*Komisioni Evropian e fillon dialogun për liberalizim të vizave*

### **10 shtator 2012**

*Kosova e shpallë përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur*

### **10 tetor 2012**

*Studimi i fizibilitetit për MSA-në*

### **25 korrik 2014**

*Inicimi i MSA-së ndërmjet BE-së dhe Kosovës*

**27 tetor 2015**

*Nënshkrimi i MSA-së*

**10 mars 2016**

*Kuvendi i Kosovës e miraton PKZMSA-në*

**1 prill 2016**

*MSA hyn në fuqi*

**4 maj 2016**

*Komisioni Evropian i propozon institucioneve të BE-së liberalizimin e vizave për qytetaret e Kosovës*

**9 nëntor 2016**

*Qeveria e Kosovës e aprovon Agjendën e Reformës Evropiane për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe politike të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit*

**1 korrik 2018**

*Komisioni Evropian konfirmon se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave*